

Informatat dhe mjekimi pas konsultimeve

Përkujdesja shëndetësore dhe mjekimi duhet të planifikohen sa më mirë duke përfshirë konsultimet në mes jush si pacientit dhe përkujdesësit tuaj. Kjo do të thotë që ju dhe personeli së pari duhet t'i diskutoni të gjitha opsionet e mundshme dhe të bini në pajtim për zgjedhjen më të mirë.

Personeli i përkujdesjes duhet të ndihmojë në vlerësimin e opsioneve të ndryshme të kontrollit dhe të mjekimit, të ofrojë udhëzime në mënyrë aktive dhe të përkujdeset që keni mjaft informata që të jeni në gjendje të merrni pjesë në vendim.

Stafi gjithashtu duhet të jetë elastik sa u përket informatave dhe nivelit të ndikimit që ju keni dëshirë të keni në këtë proces. E drejta për t'u informuar si duhet ju takon gjithnjë, por vendimet me përgjegjësi mund t'ua lini edhe atyre që posedojnë kompetencë mjekësore. Pavarësisht se çfarë shkalle ndikimi të zgjedhni, megjithatë ju takon cilësia e njëjtë e përkujdesjes.

Keni të drejtë statutores të ju informojnë në mënyrë të *kuptueshme*, në veçanti lidhur me:

- gjendjen tuaj shëndetësore, diagnozën dhe parashikimin
- rezultatet e kontrollit dhe të mjekimit tuaj
- metodat e mundshme të kontrollit dhe mjekimit
- orarin e planifikuar të kontrollit dhe mjekimit tuaj
- çdo program të përkujdesjes të caktuar për problemet tuaja të veçanta
- kohën e pritjes për mjekim dhe operim në spitale të ndryshme
- atë se si mund të bashkëpunoni edhe vetë në mjekim
- atë se si mund t'u shmangeni sëmundjeve dhe lëndimeve
- efektet parësore dhe efektet e mundshme dytësore të ilaçeve dhe terapive

Që të jeni në gjendje të ndikoni në mjekimin tuaj duhet që mjeku të ju këshillojë lidhur me disa mundësi të ndryshme të mjekimit.

Pyesni nëse nuk kuptoni

Keni të drejtë të ju silltet për ndihmë një përkthyes nëse keni probleme me dëgjim ose me të folur, ose nëse nuk e kuptoni suedishten aq mirë.

Nëse të drejtat tuaja nuk jeni në gjendje t'i mbronin vetë, këtë mund ta bëjë ndonjë i afërm ose ndonjë shok për ju.

Fshehtësitë profesionale

Të gjithë të punësuarit në përkujdesje shëndetësore janë të detyruar t'i ruajnë fshehtësitë profesionale. Informatat lidhur me ju, sëmundjen ose mjekimin tuaj nuk lejohet t'i jepen askujt që këto nuk i shërbejnë për të ju ofruar përkujdesje mjekësore.

Do të mund ta vendosni vetë se çfarë informatash mund të shpërndahen dhe kujt.
Kjo vlen edhe për informatat që u jepen të afërmve tuaj.

Rivlerësimi

Nëse nuk jeni të kënaqur me propozimet e mjekut lidhur me mjekimin ose kontrollin, mjeku në disa raste të caktuara është i obliguar të ju ofrojë rivlerësim mjekësor. Kjo vlen vetëm për sëmundjet që mund ta rrezikojnë jetën (posaçërisht për ato që konsiderohen të rrezikshme) ose për lëndime. Kjo nënkupton që ju si pacient duhet të vendosni a pajtoheni me mjekimet që kanë rrezik të lartrë ose që vendimi është shumë i rëndësishëm për cilësinë e ardhshme të jetës suaj.

Në situata të tilla duhet të ju lejohet rivlerësimi kudo në vend e poashtu edhe mjekimi që të caktohet në këtë rivlerësim.

Trajtimi me respekt

Personeli i infermierëve e ka për detyrë të qartë që çdo pacient ta trajtojë me konsideratë dhe respekt. Personave të sëmurë duhet t'u ofrohet përkujdesja e përshtatshme dhe e përpiktë si dhe ndjenja e sigurisë.

Bashkëveprimi në mes jush si pacient dhe personelit përkujdesës është bazë për përkujdesje të mirë. Ky bashkëveprim duhet të jetë i bazuar në respekt të ndërsjellë ndaj dijes dhe përvojës së tjetrit. Si pacient, ju keni përvojë dhe dije lidhur me shëndetin dhe sëmundjen tuaj. Personeli është i detyruar t'i respektojë kufizimet individuale lidhur me mënyrën se si dëshironi ose jeni në gjendje të komunikohet me ju. Si pacient mbani përgjegjësi ta njoftoni personelin lidhur me të gjitha informatat e nevojshme kështu që ata të jenë në gjendje të ju përkujdesin mirë. Duhet të pyesni nëse nuk kuptoni, duhet të shtroni kërkesa, të jepni propozimet tuaja si dhe të jeni të hapur në bisedat tuaja me personelin përkujdesës.